

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH Nr. 496/16

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092 në përbërje prej: z. Ekrem Salihu – Kryetar, z.Nuhi Paçarizi- referues, z. Goran Milenkovic – anëtar, si dhe duke u bazuar në nenin 99 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092 dhe konform nenit 39 të Rregullores së punës së OSHP-së nr. 02/2015, pas shqyrtimit të kërkesës së autoritetit kontraktues /Policia e Kosovës/, që OSHP-ja të veproj konform nenit 99 të LPP-së, përkitazi me konsorciumin “5 Vëllezërit Mulaku&NNP Euro Construction”-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Renovimi i qendrave të ndalimit në Stacionit Policor Prishtinë, Glllogovc, Podujevë dhe Lipjan”, me nr. të Prokurimit: 214/16/045/521, më 20 janar 2017, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet**, si e bazuar, kërkesa e Autoriteti Kontraktues (AK) /Policia e Kosovës/e dt: 14.01.2015, për diskualifikim nga pjesëmarrja në prokurim publik të operatorit ekonomik “5Vëllezërit Mulaku”-Prishtinë.
- II. Refuzohet**, si e pa bazuar kërkesa e autoritetit kontraktues, për diskualifikim të OE “NNP Euro Construction” - Rahovec.
- III. Diskualifikohet**, nga pjesëmarrja në prokurim publik, për periudhën gjashtëmujore (6 muaj) operatori ekonomik “5 Vëllezërit Mulaku”-Prishtinë.

- IV.** Ky vendim hyn në fuqi nga data e dërgimit të të njëjtit operatorit ekonomik dhe autoritetit kontraktues.

ARSYETIM

Autoriteti kontraktues / Policia e Kosovës /, me dt.:02.06.2016 ka parashtruar kërkesë, në OSHP, që të veprohet konform nenit 99.2 të LPP-së, pasi që sipas tyre konsorciumi “5 Vëllezërit Mulaku&NNP Euro Construction”-Prishtinë ka falsifikuar noterizimin e një diplome të inxhinierit të arkitekturës-Dega e Arkitekturës..

Seanca e shqyrtimit kryesor të datës 20.01.2017, është mbajtur pa praninë e palëve, pasi që nuk kanë prezantuar përfaqësuesit e OE “5 Vëllezërit Mulaku” dhe përfaqësuesi i AK-së, edhe pse dy herë radhazi janë njoftuar përmes telefonit për të konfirmuar pjesëmarrjen në seancë, ndërsa herën e fundit OE i lartpërmendur është ftuar edhe në prani të anëtarëve të panelit shqyrtues me datë 19.01.2016 në ora 11.25, i njëjti OE. nuk ju ka përgjigjur ftesës dhe nuk ka qenë prezent në seancën e sotme duke mos dhënë ndonjë arsytim apo duke mos bërë kërkesë për shtyrje të seancës.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që ja ka bashkangjitur autoriteti kontraktues, kërkesës për diskualifikim të konsorciumit të lartpërmendur, si dhe duke u bazuar në të gjitha provat dhe kronologjinë sqaruese nga eksperti i OSHP-së, konstaton se OE “5 Vëllezërit Mulaku” ka prezantuar diplomën e z. Armend (Hajrush) Fazliu me vulë të noterës Valbona. Y. Murtezi Bytyqi në aktivitetin e prokurimit “Renovimi qendrave të ndalimit në stacionin policor Prishtinë, Gillogovc, Podujevë dhe Lipjan” me nr të prokurimit: 214/16/045/521.


Ndërsa pas kërkesës së autoritetit kontraktues drejtuar noterës së lartpërmendur për të sqaruar dhe konfirmuar se nëse ajo e ka noterizuar diplomën e inxhinierit të diplomuar të arkitekturës z. Armend (Hajrush) Fazliu, në përgjigjen e dt.:27.04.2016 e njëjta notere sqaron se ajo nuk e ka noterizuar këtë diplomë. Prandaj duke pasur parasysh këtë fakt rezulton se OE “5 Vëllezërit Mulaku” ka falsifikuar dokumentin e dosjes së tenderit, pra diplomën e inxhinierit në fjalë, e ka prezantuar kinse është e noterizuar, e që në fakt kjo diplomë në anën e kundërt ka përmbajtur të falsifikuar vulën dhe tekstin e noterizimit nga noterja Valbona. Y. Murtezi Bytyqi.

Paneli shqyrtues konstaton se kërkesa e autoritetit kontraktues ka qenë që të diskualifikohet konsorciumi “5 Vëllezërit Mulaku&NNP Euro Construction”-Prishtinë, mirëpo faktet për diskualifikim ekzistojnë vetëm për OE “5 Vëllezërit Mulaku” si lider i konsorciumit, ndërsa për anëtarin tjetër të konsorciumit-OE “NNP Euro Construction” nuk ekziston asnjë fakt dhe dëshmi që ky operator ekonomik ka falsifikuar ndonjë dokument apo që ka ofruar dëshmi të rrejshme, prandaj kërkesa që të diskualifikohet edhe ky operator ekonomik është e pabazuar dhe e pa argumentuar me fakte.

Paneli shqyrtues, nga të cekurat më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur nuk mund të ushtron ankesë, por për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh, pas pranimit të këtij vendimi, me kërkesë-padi mund të drejtohet. Departamentit për çështje Administrative, në Gjykatën themelore Prishtinë



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – Policia e Kosovës

1x1 OE "5 Vëllezërit Mulaku"-Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së